

## MAQEDONI: IVANOVI, SHQIPTARËT DHE LOJA ME ZJARRIN

Nga Xhavit Shala

Akoma pa mbushur muajin në postin e presidentit të Maqedonisë, George Ivanovi provokoi hapur shqiptarët në rajon, duke shpërfillur dy here shtetin e ri të Kosovës dhe kryetarin e saj Fatmir Sejdiu.<sup>1</sup> Veprimet e tij janë në vazhden e papërgjegjshmërisë se politikës zyrtare maqedonase në raport me shqiptarët. Me veprime e qendrimet e tilla ata po ndikojnë në përkeqësimin e marrëdhënieve ndëretnike të brishta në Maqedoni dhe po luajnë me zjarrin duke shpërfillur e injoruar bashkëshitetasit e tyre shqiptarët në Maqedoni.

Ivanovi e ka të vështirë të pranojë realitetin e ri në Kosovë. Ai po tregon vendosmeri për të ndjekur hapur një politikë proserbe në raport me Kosovën, pa menduar për pasojat që kjo politikë mund ti sjellë vendit të tij dhe rajonit. Shqiptarët në Maqedoni përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë dhe vetë Maqedonia tashme kufizohet me dy shtete shqiptare, Shqipërinë dhe Kosovën. Megjithatë maqedonasit vazhdojnë të shpërfillin shqiptarët dhe kanë zgjedhur Serbisë si aleatin kryesor në rajon, me të cilën e lidhin vetem të qenit fqinjë dhe një minoritet i vogël serb prej 1,78 % të popullsisë së Maqedonisë. Duket se është antishqiptarizmi filli që lidh segmente të fuqishme të politikës maqedonase me ato serbe, ndonëse politika zyrtare si në Shqipëri, ashtu dhe Kosovë në vazhdimësi e ka mbështetur stabilitetin e shtetit maqedonas.

Në të vërtetë pozicioni i Ivanovit në raport me shqiptarët nuk është se ka ndonjë ndryshim të madh nga ai i promovuesit të tij, kryeministrit Nikolla Gruevski, dhe se pozicioni i të dy liderve është mishërim i qëndrimit që ka mbajtur dhe mban ndaj shqiptarëve partia e tyre nacionaliste VMRO-DPMNE.

Si subjekt politik VMRO-DPMNE, ndonëse është nënshkruese e marrëveshjes së Ohrit, shpesh e ka shtuar pasigurinë mbi të ardhmen e Maqedonisë duke dhënë her pas herë shenja se është gati të heqë dorë nga zbatimi i asaj marrëveshjeje. Ky subjekt ka përkrahur edhe një projekt të Akademisë së Shkencave të Shkupit për ndarjen e Maqedonisë.

Vetë kjo parti ka patur dhe ka politikane që akoma nuk po pajtohen me mendimin se shtetin e Maqedonisë e kanë bashkë me shqiptarët, si grupi më i madh etnik pas sllavo maqedonasve dhe se Maqedonia nuk do të mund të ekzistojë si shtet me përmasat e sotme nëse nuk respekton e përfshin shqiptarët.

---

<sup>1</sup> Shkrimi është botuar në gazetën "Shqip" datë 3.6.2009

Ishte kjo force politike në pushtet në vitin 2001 ajo që nuk i la asnjë mundësi për përmbushjen në rrugë paqësore të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni dhe i detyroi ata që të nisnin levizjen e armatosur.

Në vazhdimësi problemi më i madh i klasës politike maqedonase ka qenë dhe mbetet keqmenaxhimi i raporteve me popullsinë shqiptare, e cila jeton në trojet e veta në Maqedoninë Perëndimore. Cështja e sotme e pazgjidhur shqiptare në Maqedoni i ka rrënjët në histori. Ajo fillon me Traktatin e Shen Stefanit, nënshkruar në përfundim të luftës Ruso-Turke të vitit 1878 dhe Kongresin e Berlinit të po atij viti, thirrur nga Fuqitë e Mëdha Perëndimore në përgjigje të Traktatit të Shën Stefanit.

Vazhdon më pas Konferencën e Londrës së vitit 1913, e cila ndonëse e njohu Shqipërinë si shtet të pavarur çënoi rëndë kufijtë e saj, duke shkëputur nga trungu etnik rreth gjysmën e trojeve, përfshirë këtu dhe trojet e sotme shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe përmyllet me Kongresin e Versajës në vitin 1919, ku u bë zyrtarizimi i ndarjes përfundimtare të këtyre trojeve nga shteti amë.

Trojet shqiptare që tashmë përfshihen në Maqedoni, ashtu si dhe Kosova, Camëria dhe trojet e tjera ju morën forcërisht Shqipërisë. Këto territore, në përmbushje të marrëveshjeve dhe lëshimeve reciprokë të Fuqitë të Mëdha të kohës dhe në përputhje me interesat e tyre gjeopolitike ju dhanë aleatëve të tyre ballkanas, fqinjëve tanë grabitqar.

Duke ligjëruar ndarjen e trojeve shqiptare, përfshirë këtu edhe atë pjesë që ndodhet brenda kufijve të sotëm shtetëror të Maqedonisë, diplomacia e kohës, bëri një nga investimet e saj më të këqia e afatgjate për paqen dhe sigurinë në Ballkan. Konflikti i vitit 2001 në Maqedoni, midis shqiptarëve etnik dhe forcave maqedonase të sigurisë ishte një nga pikat kulmore të këtij konflikti.

Por deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore edhe maqedonasit nuk patën ndonjë status më të favorizuar se shqiptarët. Pas krijimit të Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve dhe më vonë të Jugosllavisë së Parë, represioni dhe gjenocidi ndaj shqiptarëve mori formë institucionale. Më këtë problem fillojnë të merret vetë Akademia e Shkencave. Jugosllavia u kthye në një burg të madh popujsh, ku përvec shqiptarëve ishin të "burgosur" edhe vetë maqedonasit.

Starti thuajse i barabartë i shqiptarëve dhe maqedonasve u prish në Jugosllavinë e Titos. Shqiptarët e maqedonisë jo vetëm që nuk u bashkuan më Shqipërinë, por u ndanë edhe nga shqiptarët e Kosovës. Ndërsa maqedonasit nga ana e tyre, duke përfutur statusin e republikës, për një kohë të shkurtër i formuan të gjitha institucionet e veta.

Më pas, në vitet e komunizmit, maqedonasit i diskriminuan shqiptarët dhe i trajtuan ata si qytetare të dorës së dyte. Duke jetuar në një teritor kompakt në Maqedoninë Perëndimore dhe në kryeqytetin Shkup, shqiptarët, në vitet 70-80, vuajtën prej keqtrajtimit të autoriteteve komuniste të Shkupit, më shumë se shqiptarët në Kosovë.

Në vitin 1981, duke ndjere frikën nga rilindja kombëtare e shqiptarëve të Kosovës, autoritetet komuniste të Shkupit filluan një represion të pa parë ndaj shqiptarëve të Maqedonisë, sidomos ndaj inteligjencisë. Kulmin ky represion e arriti në vitin 1989. Maqedonasit, në veprimet e tyre antishqiptare, kopjonin në çdo hap të tyre Milloshevicin, por duke i thelluar më tepër ato.

Kur Jugosllavia ishte në procesin e shpërbërjes, maqedonasit në shtator 1991, organizuan referendumin e tyre për pavarësi. Nderkohë, shqiptarët në Maqedoni menduan se kishte ardhur momenti për të zgjidhur statusin e tyre juridiko-kushtetues. Por kushtetuta e vitit 1991, nuk përfillte realitetin e brendshëm të përbërjes etnike të shtetit të ri maqedonas, duke u bërë kështu gjeneruesi kryesor i krizës në vend. Karakteri i saj thellësisht nacionalist maqedonas çenonte rëndë interesat kombëtare të shqiptarëve. Për këtë arsye deputetët shqiptar nuk e votuan në parlament këtë kushtetutë.

Duke qënë autokton në trojet e tyre, shqiptarët dolën me kërkesat e veta për të qënë element shtetëformues, ku gjuha e tyre të përdorej si gjuhë e dytë. Kërkuan të drejtat deri në arsimin e lartë, të drejta për punësim, për përfshirje proporcionale në institucionet shtetërore e strukturat e sigurisë. Këto kërkesa në vazhdimësi u anashkaluan nga autoritetet maqedonase.

Pas aprovimit të kushtetutës maqedonase të vitit 1991 dhe shpërfilljes së kërkesave të tyre, shqiptarëve në Maqedoni nuk ju mbeti gjë tjetër vecse të kërkonin rrugë të tjera për të realizuar të drejtat e tyre kombëtare. Njëra nga këto rrugë ishte organizimi i një referendumi të veçantë, ku populli shqiptar i Maqedonisë të shprehte vullnetin e vet përmes deklaratimit gjithëpopullor.

Autonomia e shpallur me referendumin e mbajtur më 11 e 12 janar 1992, për shkak të veprimtarisë përçarëse që autoritetet maqedonase organizuan mes faktorit politik shqiptar të kohës, mbeti vetëm në letër. Megjithatë ky referendum ishte një paralajmërim dhe kundërpërgjigje ndaj të gjitha vendimeve të njëanshme të politikës maqedonase dhe injorimit prej tyre të interesave kombëtarë të shqiptarëve.

Në vazhdimësi autoritetet maqedonase, me propogandën e tyre, janë përpjekur dhe janë treguar të suksesshëm që në opinionin ndërkombëtar të krijonin

mendimin e rrejshëm se marrdhënjet ndëretnike në Maqedoni janë të mira. Aq u besua mashtrimi i tyre sa që Maqedonia u bë vendi i parë nga Ballkani Perëndimor që nënshkroi marreveshjen e Stabilizim-Asocimit me vendet e BE-së.

Shperthimi i luftës në Kosovë dhe progami i UCK-se, duke kërkuar pavarësi për Kosovën, natyrshëm mund të tërhiqte edhe shqiptarët e Maqedonisë, për tu bashkuar të gjithë së bashku me Kosovën, nga e cila ishin ndare administrativisht pas Luftës së Dytë Botërore, për të jetuar në një shtet të vetëm shqiptar. Por drejtuesit e UCK-se nuk lejuan përhapjen e konfliktit në Maqedoni. Kjo për të siguruar një mbështetje më të fuqishme ndërkombëtare për luftën e tyre në Kosovë, si dhe për të dhënë një mundësi autoriteteve maqedonase për të zgjidhur pa humbur kohë në rrugë paqësore kërkesat e drejta të shqiptarëve atje.

Por autoritetet maqedonase përsëri ndoqën modelin serb të “dialogut” me shqiptarët dhe kështu në fillim të vitit 2001 në Maqedoni shpertheu konflikti i armatosur. Shkaku kryesorë pse shqiptarët e Maqedonisë ju drejtuan armëve për të fituar të drejtat e tyre kombëtare ishte konsumimi i plotë i rrugës paqësore, humbja e besimit nga ana e tyre se me mjete paqësore ata do të mund të korigjonin pozitën e tyre juridiko-kushtetues e të fitonin të drejtat e tyre kombëtare.

Nëse lufta midis shqiptarët dhe forcave maqedonase të sigurisë do të thellohej më tej, siguria e pesë vendeve kufitare me të, Shqipërisë, Kosovës, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë do të çenohej drejtpërdrejt. Lufta në Maqedoni do të destabilizonte Ballkanin jugor dhe do të rrezikonte të përhapte konfliktin jo vetëm përtej ish Jugosllavisë por edhe më gjërë. Nato-ja (sidomos SHBA-ja) me interesat e saj jetike në Mesdheun Lindor, nuk mund ta lejonte shtrirjen e konfliktit.

Për këtë komuniteti ndërkombëtar u angazhua fuqimisht në zgjidhjen e këtij konflikti dhe nën tryshninë e tyre u firmos Marrëveshja e Ohrit. Por, ndërsa shqiptarët u carmatosën dhe ju kthyen dialogut, zbatimi i plotë i marrëveshjes së Ohrit është vënë seriozisht në dyshim. Ndërkohë, që nuk duan t’u japin shqiptarëve plotësisht ato të drejta që janë planifikuar në marrëveshjen kornizë të Ohrit, politika aktuale maqedonase po synon, ashtu si para konfliktit të vitit 2001, që të mashtroje përsëri faktorin ndërkombëtar për gjoja respektimin e të drejtave të shqiptarëve.

Dhe këtë po e bën me synimin që të mos të ketë pengesa në proceset integruese euroatlantike. Duket se strategjia maqedonase është që nëpërmjet mashtrimeve dhe lojrave gjeopolitike, të mund të arrijë integrimin e plotë të Maqedonisë në BE, pa zbatuar pikat më të rëndësishme të marreveshjes së Ohrit. Dhe me pas shteti i tyre nuk do të marrë përsipër avancimin e të drejtave kombëtare të

shqiptarëve atje. Ato do të trajtohen thjesht si përpjekje për “barazi ligjore dhe politike të të gjithë individëve”. Njëlloj sic po vepron sot Greqia, anëtare e BE-se, duke i mohuar pakicat kombëtare e duke i trajtuar të drejtat e tyre në kuadrin e barazisë ligjore dhe politike të gjithë individëve.

Politika e anashkalimit të drejtave të shqiptarëve dhe e zvarritjes së zbatimit të plotë të Marrëveshjes së Ohrit, është pa të ardhme dhe e rrezikshme. Faktori politik shqiptar atje duhet të jetë i vendosur dhe i prerë në zbatimin e asaj marrëveshje. Përndryshe, nëse ata heshtin nisur nga lakmia për pushtet, do të kujtohen në histori si tradhtarë të kombit shqiptar.

Pa zbatimin e plotë dhe pa ekuivok të Marrëveshjes së Ohrit nuk mund të këtë Maqedoni më shqiptarë dhe në kufijtë e saj të sotëm. Nga ana tjetër edhe faktori ndërkombëtar si pale e tretë nënshkruese dhe garantuese e Marrëveshjes së Ohrit duhet të gjej mekanizmat për të detyruar politikën maqedonase të respektojë plotësisht atë marrëveshje. Përndryshe zjarri në dukje i vogël, të cilin e ndezi Ivanovi me veprimet e tij provokuese ndaj shqiptarëve, mund të përhapet shpejt pasi është ndezur në një vatër ku ka më shumë prush se sa hi nga kriza e pazgjidhur e vitit 2001. Dhe ky zjarr i ndezur nga politika e papërgjegjshme maqedonase rrezikon paqen dhe stabilitetin e Evropës Juglindore.

Xhavit Shala